



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1346/004
Dt 04. 10. 2017

Në bazë të nenit 48 dhe 49 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2017, mori:

VENDIM

- I. Lejohet vazhdimi i kontratave të personelit akademik me titull ligjërues, prej 30.9.2017-30.9.2018.
- II. Me secilin ligjërues do të lidhet kontratë individuale me kushtet e njëjta siç kanë qenë të përcaktuara në kontratat e mëhershme.
- III. Ass. Arbërie Krasniqi, asistente e matematikës në FIMK, i vazhdohet kontrata në kushte të njëjta sikurse edhe ligjëruesve, d.m.th. prej 30.9.2017-30.9.2018.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 47 dhe 48 të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it, si dhe duke pasur parasysh nevojën e mbarëvajtjes së procesit mësimor, e konsideroi të domosdoshëm vazhdimin e kontratave për këtë kategori të personelit akademik. Gjithashtu, edhe personeli nga pika III e këtij vendimi është kategori deficitare dhe ndikon ndjeshëm në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Nga sa u tha më sipër, Senati i Universitetit mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Drejtorit të DAP;
4. Zyrtarit për paga;
5. Zyrës së personelit;
6. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it